

URDHËR
Nr. 327, datë 26.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 122, DATË 6.3.2023, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PRAKTIKAT UNIFORME NË KRYERJEN E
KONTROLLEVE MBI PËRDORIMIN E SUBSTANCAVE FARMAKOLOGJIKISHT
AKTIVE TË AUTORIZUARA SI PMV OSE SI ADITIVË PËR USHQIMET E
KAFSHËVE DHE MBETJEVE TË TYRE, MBI SUBSTANCAT
FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË NDALUARA OSE TË PAAUTORIZUARA
TË PËRDORURA NË KAFSHËT QË PRODHONË USHQIM, MBETJET E TYRE,
SI DHE PËR PËRMBAJTJEN SPECIFIKE TË PLANEVE TË KONTROLLIT DHE
MËNYRAT E HARTIMIT TË TYRE, PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË
MONITORIMIT TË MBETJEVE”¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 3 të nenit 81, pikës 8, të nenit 102, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në rregulloren bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të urdhrin nr. 122, datë 6.3.2023, “Për miratimin e rregullave për praktikat uniforme në kryerjen e kontrolleve mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuara si PMV ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe mbetjeve të tyre, mbi substancat farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paautorizuara të përdorura në kafshët që prodhojnë ushqim, mbetjet e tyre, si dhe për përmbajtjen specifike të planeve të kontrollit dhe mënyrat e hartimit të tyre, për zbatimin e Planit Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 7 i rregullores riformulohet si vijon:

“Neni 7

Përmbajtja shtesë e planeve kombëtare të kontrollit të bazuara në risk dhe planit të mbikëqyrjes së rastësishme

1. Planet kombëtare të kontrollit të bazuara në risk, sipas parashikimeve në nenet 4 dhe 6, dhe Plani Kombëtar i Mbikëqyrjes së Rastësishme, sipas parashikimeve të nenit 5, përcaktojnë informacionet si vijon:

- a) llojet e kafshëve që do i nënshtrohen kampionimit dhe vendin e kampionimit;
- b) legjislacionin kombëtar mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive dhe, në veçanti, ndalimin ose autorizimin e tyre, shpërndarjen, hedhjen në treg dhe administrimin, në atë masë në të cilën legjislacioni nuk është i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- c) autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e planeve.

2. Planet kombëtare të kontrollit të bazuara në risk, sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 6, përveç informacioneve të përshkruara në paragrafin 1, përfshijnë edhe si vijon:

¹ Ky urdhër përafron rregulloren e deleguar (BE) 2024/2563, të Komisionit, datë 24 shtator 2024, e cila ndryshon rregulloren (BE) 2022/1646, të Komisionit Evropian, të miratuar me urdhrin e ministrit nr. 122, datë 6.3.2023, “Për miratimin e rregullave për praktikat uniforme në kryerjen e kontrolleve mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuara si PMV ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe mbetjeve të tyre, mbi substancat farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paautorizuara, të përdorura në kafshët që prodhojnë ushqim, mbetjet e tyre, si dhe për përmbajtjen specifike të planeve të kontrollit dhe mënyrat e hartimit të tyre, për zbatimin e PKMM-së”.

a) një argumentim për substancat, llojet e kafshëve, produktet dhe matricat e përzgjedhura dhe të përfshira në plane mbi bazën e kriterëve të listuara në anekset II dhe VI, të urdhrit të nr. 85, datë 17.2.2023, të ndryshuar, duke përfshirë një argumentim të mënyrës në të cilën janë mbajtur parasysh kriteret e listuara në anekset e sipërpërmendura edhe kur nuk janë bërë ndryshime përkundrejt planit të vitit paraardhës;

b) një argumentim, lidhur me mënyrën në të cilën janë mbajtur parasysh informacionet e marra lidhur me rastet e papërputhshmërisë në vend, të konstatuara gjatë tre viteve kalendarike, me qëllim përmirësimin e planit.”.

2. Titulli i nenit 8 të rregullores, ndryshon si vijon:

“Paraqitja dhe vlerësimi i Planit Kombëtar të Kontrollit Mbështetur në Risk dhe Planit Kombëtar të Mbikëqyrjes së Rastësishme”.

3. Shkronja “b”, e aneksit I ndryshon si vijon:

“b) Kontrollat mbi secilin kombinim të nëngrupeve të substancave të grupit A dhe grupeve të produkteve të përshkruara nga aneksi II, të urdhrit nr. 85, datë 17.2.2023, të ndryshuar, kryhen çdo vit mbi të paktën 5% të kampioneve të marra, në përputhje me kërkesat e tabelës së këtij aneksi për atë grup produktesh. Kjo përqindje minimale nuk zbatohet për zorrët dhe as për substancat e grupit A, paragrafi 3, shkronjat “b” dhe “f”, për të gjitha grupet e produkteve.”.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla